



UNIVERSITETI I PRISHTINËS FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 209 * Email: edukimi@uni-pr.edu * edukimi.uni-pr.edu

Abstrakt i zgjeruar

Titulli i Punimit:

NDËRLIDHJA NË MES TË INTERESIMIT PËR TË NXËNË LËNDËN E FIZIKËS DHE DALLIMEVE GJINORE TË NXËNËSVE TË KLASAVE XI DHE XII

Autori:

Diellza Gashi

Mentori:

Prof.Asoc.Gazmend Nafezi

Programi:

Master i mësimdhënies lëndore: Mësimdhënia e Fizikës

Viti akademik:

02.04.2026

Hyrja

Përkundër rolit të lëndës së fizikës në formësimin e mendimit kritik, analizën logjike dhe kuptimin e natyrës për rreth tek nxënësit, interesimi i tyre për të nxënë këtë lëndë është i ulët. Ekzistojnë perceptime të tilla ndër nxënës që fizika është lëndë abstrakte dhe e vështirë për të u kuptuar, e më pas këto perceptime ndikojnë në nivelin e interesimit tyre për të mësuar. Si rezultat, identifikimi i faktorëve që ndikojnë në këtë nivel interesimi është bërë një domosdoshmëri pedagogjike. Një faktor, i cili ka marr vëmendje ndër vite është edhe dallimi gjinor. Në këtë hulumtim trajtohet niveli i interesimit për të nxënë lëndën e fizikës, duke shqyrtuar faktorët që ndikojnë në këtë interesim, me fokus të veçantë në dallimet gjinore.

Pyetjet kërkimore janë:

1. Në çfarë mase ndikon gjinia e nxënësve në interesimin e tyre për të nxënë lëndën e fizikës?
2. Si ndikojnë stereotipet gjinore në përkushtimin e nxënësve ndaj lëndës së fizikës?

Metodologjia

Modeli i këtij hulumtimi është korrelativ sepse analizon ndërlidhjen në mes dy variablave përkatësisht interesimin për të nxënë lëndën e fizikës dhe dallimeve gjinore. Qasja e këtij hulumtimi është kuantitative (sasiore). Mostra e përzgjedhur është joprobabilitare, kampionimi me kuotë dhe përfshin 220 nxënës të klasave të XI dhe XII në shkollën e mesme të lartë, gjimnazit “Frang Bardhi” në komunën e Mitrovicës. Instrumenti i përdorur është pyetësi i cili përmban 15 pyetje të mbyllura. Pyetësi është i shkallës Likert, me shkallë 1-5 nga fare nuk pajtohem deri pajtohem plotësisht. Të dhënat e mbledhura janë analizuar në mënyrë deskriptive dhe inferenciale duke përdorur programin SPSS.

Rezultatet kryesore

Rezultatet tregojnë se ekziston një lidhje pozitive e moderuar dhe statistikisht domethënëse në mes të interesimit për të nxënë lëndën e fizikës dhe dallimeve gjinore me një koeficient të korrelacionit $r = 0.39$, ku nxënësit meshkuj priren të shfaqin interes më të lartë për të nxënë lëndën e fizikës krahasuar me nxënëset femra. Mirëpo rezulton që gjinia nuk është faktori i vetëm përcaktues, por ndikojnë edhe faktorë të tjerë në këtë nivel të interesimit, ku stereotipet gjinore tregojnë një koeficient të korrelacionit $r = -0.46$, pra lidhje negative mesatare me nivelin e interesimit për të nxënë lëndën e fizikës, mjedisi mësimor ka një koeficient korrelacionit $r = 0.58$ pra lidhje pozitive të fortë, dhe vetë efikasiteti $r = 0.62$, pra lidhje pozitive shumë të fortë.

Diskutimi

Rezultatet e dala nga ky hulumtim tregojnë se ekzistojnë faktorë të ndryshëm të cilët ndikojnë në nivelin e interesimit për të nxënë lëndën e fizikës, një ndër ta edhe ndikimi i dallimeve gjinore. Një numër i madh i hulumtimeve tregojnë që gjinia ndikon në mënyrë të ndjeshme në nivelin e interesimit për të nxënë lëndën e fizikës, ku sipas Baran (2016) natyrshëm djemtë ishin më të interesuar për zgjidhje të problemeve në lëndën e fizikës, dhe në hap me zhvillimet në shkencat natyrore në përgjithësi. Në anën tjetër rezultate të tilla, për sa i përket ndikimit të faktorëve tjerë si stereotipet gjinore, mjedisi mësimor dhe vetë efikasiteti, kanë dalë edhe në hulumtime të Ortega-Torres et al. (2020), Arnel&James (2024) dhe Allison Master (2021), të cilët konfirmojnë ndikimin e këtyre faktorëve në interesimin e nxënësve për të nxënë lëndën e fizikës.

Përfundimet dhe rekomandimet

Nga ky hulumtim, konkludohet se gjinia ka ndikim pozitiv të moderuar në nivelin e interesimit për të nxënë lëndën e fizikës, por nuk është faktori i vetëm përcaktues. Ekzistojnë edhe shumë faktor tjerë që ndikojnë, ndër ta edhe prania e stereotipeve gjinore, mjedisi mësimor dhe vetë efikasiteti i nxënësve. Nga ky hulumtim rekomandohet për shkollat të krijohen praktika dhe politika shkollore që promovojnë barazi gjinore, të forcohet roli i psikologut në shkollë, pastaj për mësimdhënësit të krijojnë mjedis të sigurt dhe mbështetës në klasë, të mos shfaqin qëndrime që nxisin stereotipe gjinore, të përdorin metoda interaktive në klasë si dhe për prindërit të mbështesin interesimin e fëmijëve të tyre për lëndët shkencore pa dallim gjinie dhe të komunikojnë me ta në mënyrë të vazhdueshme. Për hulumtimet e ardhshme rekomandohet të përfshijnë mostra më të gjera dhe shkolla të ndryshme për të rritur përgjithsueshmërinë e rezultateve, dhe të realizohen studime eksperimentale të cilat e shqyrtojnë ndikimin e ndërhyrjeve pedagogjike në reduktimin e dallimeve gjinore.

Fjalë kyçe: *dallime gjinore, fizikë, interesim, nxënës.*